

VENDIM
Nr.319, datë 19.3.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË PËR
MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE TË
IMPORTUAR NGA KESH SHA ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun I të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3.2, fjalët “Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në gjashtë muaj nga kryerja e zhdoganimit.”, zëvendësohen me “Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në dymbëdhjetë muaj nga kryerja e zhdoganimit.”.

2. Në pikën 5, fjalët “...brenda gjashtë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe të pajisjeve ...” zëvendësohen me “...brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe të pajisjeve...”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 7, fjalët “...brenda gjashtë muajve nga çasti i kryerjes së importit...” zëvendësohen me “...brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i kryerjes së importit...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha